




Primitar / Doretzuar Primitano / Pricalato Received / Delivered	31. 12. 2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK/6488/2021			1/6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1058/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1258/20 të datës 26.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.16/2019 të datës 15.01.2019 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë Rruga "William Woker", Nr. 40 në Komunën e Shtimes, kundër Vendimit me Nr. 02-070/05-28712/114 të datës 24.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një (1) vjet", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.12.2021, mori këtë:**

**V E N D I M**

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.695/2018 të datës 26.10.2018 të parashtruar nga ankuesi [redacted]**
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 02-070/05-28712/114 i datës 24.12.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes.**
- III. Ndryshohet Vendimi me Nr. 01/ID.Nr.74 i datës 28.08.2018 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Shtimes, ku masa disiplinore "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për pesë (5) vjet", ndaj ankuesit ndryshohet me masën disiplinore "largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një (1) vit".**
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Shtimes, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit 15 ditorë nga dita e pranimit të tij, duke nxjerr akti administrativ në pajtim me këtë vendim, duke e kthyer ankuesin në pozitën Inspektor i Shërbimeve Publikë dhe Komunikacionit sipas Shkresës së Emërimit të datës 31.01.2011.**



V. **Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Shtimes, të bëjë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi për Zyrtarët Publikë.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2011 në pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit" në Komunën e Shtimes, më datë 02.08.2018 nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt [redacted] është iniciuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor me arsyetimin se: *"më datë 01.08.2018 i është drejtuar inspektorëve të tjerë [redacted] dhe [redacted] me tone të larta duke ju bërë presion psikik se përse disa ditë më parë i kanë mbyllur dy lokale, njëra ushtron veprimtarinë e lojërave të fatit e quajtur LA-BI sh.p.k me pronar [redacted] dhe tjetra ushtron veprimtarinë pastiqeri "Marigona" me pronar [redacted] ku në atë lokal hisedar është edhe djali i [redacted] i cili është edhe asamblist komunal. Ai duke mos përfillur prezencën time si epror dhe po ashtu kolegët e tij duke u munduar që të mbrojnë interesat e tij personale filloi duke i'u thënë dy inspektorëve se ju nuk jeni kompetent për të mbyllur lokalin në fjale por kompetent është ATK... Unë si epror i tij të njëjtën ditë kërkova një deklaratë me shkrim rreth kësaj çështje nga të tre inspektorët dhe [redacted] në të ti mos u përzi në këtë punë se nuk është punë e juaja, unë i thash që unë jam shef i kësaj zyre dhe për këtë më intereson ai ma ktheu atë vendim maje për vete se mua nuk më vyen, unë i thash se atë vendim e ka lëshuar një epror më i lartë dhe ata kanë të drejtës që ta kontestojnë këtë vendim të shefit apo jo. Në bazë të këtyre konsideroj se zyrtar ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës".*

Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes me datë 28.08.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 01/ID.Nr.74 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për pesë (5) vjet"*.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 01/ID.Nr.74 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes, më datë 25.09.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes, më datë 19.10.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-070/05-28712/97 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 02-070/05-28712/97 të datës 19.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.10.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6366/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.12.2018 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.695/2018 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr. 02-070/05-28712/97 të datës 19.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes duke e

obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes që të bëjë rishqyrtimin e ankesës së ankuesit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, më datë 24.12.2018 nxjerr Vendim me Nr. 02-070/05-28712/114 me të cilin ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke e ndryshuar pikën e 1 të Vendimit të Komisionit Disiplinor me Nr. 01/ID.Nr.74 dhe duke e ndryshuar masën disiplinore në: *“largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një (1) vit”*.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 02-070/05-28712/114 të datës 24.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.01.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 188/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 21.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 26.11.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1258/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 15.01.2019.

Pas pranimit të Aktgjykimit A.nr.1258/20 të datës 26.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, më datë 30.12.2021 kemi kërkuar informata zyrtare nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Shtimes... *nëse ankuesi a është kthyer në pozitën që ka mbajtur me akt emërim apo vazhdon të jete në pozitën ku është transferuar si masë disiplinore dhe a është bërë shuarja e masës disiplinore ndaj ankuesit*. Më datë 30.12.2021 kemi pranuar informatën se ... Në detyrat e punës janë të ngjashme.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 188/2019 të datës 15.01.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-070/05-28712/114 të datës 24.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes; Vendimin me numër A.nr.695/2018 të datës 10.12.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 6366/2018 të datës 26.10.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-070/05-28712/97 të datës 19.10.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve

dhe Ankesave të Komunës së Shtimes; Vendimin me Nr. 01/ID.Nr.74 të datës 28.08.2018 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Shtimes; Procesverbalin e datës 05.10.2018 i Komisionit të Ankesave; Ankesën e datës 25.09.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes; Procesverbal për kontrollimin-inspektues Nr. 0244 i datës 24.07.2018; Memorandum Zyrtar i datës 27.07.2018 nga Policia e Kosovës; Procesverbal i datës 10.08.2018 i Komisionit Disiplinor; Formulari për raportimin e shkeljes disiplinor me Nr. 08/1-68 i datës 02.08.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 28.12.2017 dhe 27.12.2016 për ankuesin; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Inspektor i Komunikacionit dhe Shërbimeve Publike" datë 29.05.2015; Akt Emërimit të datës 31.01.2011 të ankuesit dhe Përgjigjen në ankesë e datës 09.11.2018 me numër protokolli 6711/2018; Aktgjykimin A.nr.1258/20 të datës 26.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën për informata zyrtare e datës 30.12.2021

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është, *pjesërisht e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe të gjitha shkresat e lëndës respektivisht procesverbalin për kontrollimin-inspektues të datës 24.07.2018, Njoftimin lidhur me kontrollimin e lokaleve dhe kafiterive të qytetit në bashkëpunim me inspektorët e K.K Shtimes të dërguar nga Policia e Kosovës për Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Komunës së Shtimes të datës 27.07.2018, Procesverbalet e datës 10.08.2018 dhe 05.10.2018, ka konstatuar që ankuesi me veprimet e tij nuk ka pasur sjellje korrekte ndaj udhëheqësit të tij të drejtpërdrejt, kolegëve të tij si dhe ndaj Rreshterit të Policisë së Kosovës z. [redacted] i cili në njoftimin e tij të datës 27.07.2018 për Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Komunës së Shtimes me shkrim deklaroi se: *"Vlen të ceket se të nesërmen diku rreth orës 08:45, unë si mbikëqyrës i këtij plani operativ, e kam pranuar një thirrje telefonike, ku më është prezantuar inspektori komunal [redacted] dhe gjatë bisedës i njëjti më ka thënë se dëshiron të takohet me mua, për të pirë kafe dhe për të biseduar rreth çështjes së kontrollimit të lokalit, në të cilin si bashkëpunuar është paraqitur djali i tij [redacted] ndërsa unë i kam thënë që nëse dëshiron të bisedoj, mund të vie në zyrën e njësisë së hetimeve. I njëjti në atë moment më ka thënë se ti e din fort mirë se qka kam bërë unë për ju..."*, po ashtu në bazë të deklaratave në procesverbalin e datës 10.08.2018, konstatohet se ankuesi ka pasur sjellje jo të mira ndaj udhëheqësit të tij të drejtpërdrejt si dhe është munduar të pengoj punën e kolegëve të tij, mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton s inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi sepse ankuesi me veprimet e tij ka rënë në kundërshtim me nenin 51 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: *"Nëpunësit civilë i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës"*, nenin 52 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: *"Në ushtrimin e Funksioneve të tyre, nëpunësi civil duhet të përkushtohet në zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e interesit publik dhe jo në realizimin e fitimeve personale apo për individët apo organizatave tjera"*, dhe *"Nëpunësi civil nuk do të bëjnë veprime apo të marrin vendime, të cilat i tejkalojnë kufijtë e rangut dhe funksioneve të tyre, përveç atyre të përcaktuara me këtë ligj"* dhe nenin 10 paragrafin 1 të Rregullores ( QKR) - Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Nëpunësit Civil duhet të*

*zbatojë politikat e veprimit të udhëheqëseve drejtues dhe sjellja e tyre duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionit në fuqi*". Andaj veprimet e ankuesit janë të sanksionuara me dispozitat ligjore në fuqi, sepse nëpunësit janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji dhe janë përgjegjës për të gjitha dëmet e shkaktuara ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 64 dhe 65 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Shtimes me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 01/ID.Nr.74 të datës 28.08.2018 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për pesë (5) vjet"*, ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me shkeljen që ankuesi ka bërë, mirëpo masa disiplinore e shqiptuar është masë e rëndë respektivisht ndalimi i gradimit është masë më e rëndë së shkelja në raport me shkeljen disiplinore të ankuesit, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se masat disiplinore duhet të shqiptohen në proporcion me shkeljen ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 66 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin A.nr.695/2018, ka obliguar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes, të shqyrtoj ankesën e ankuesit në raport me masën e shqiptuar, mirëpo Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Shtimes me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 02-070/05-28712/114 të datës 24.12.2018 duke aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit ka bërë edhe ndryshimin e masës disiplinore, duke tejkaluar kompetencën e tij të përcaktuar me dispozitat e Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave sepse është përcaktuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka kompetencë të vendos se a pranohet apo jo ankesa.

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, i vetmi organ që ka të drejtë të bëjë ndryshimin e masave disiplinore është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj në kuptim të dispozitave të nenit 18 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bënë ndryshimin e masës disiplinore nga *"largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për pesë (5) vjet"*, në masën disiplinore *"largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit për një (1) vit"*.

Meqenëse kemi pranuar informata zyrtare nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Shtimes se ankuesi nga momenti kur Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes ka nxjerr Vendimin me Nr. 02-070/05-28712/114 të datës 24.12.2018, është transferuar në një pozitë tjetër me pagë të njëjtë, atëherë meqë ka kaluar periudha e masës disiplinore e cila i është ndryshuar, institucioni respektivisht Kryetari i Komunës së Shtimes, është i obliguar që të nxjerr akti administrativ në pajtim me këtë vendim, duke e kthyer ankuesin në pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike dhe Komunikacionit sipas Shkresës së Emërimit të datës 31.01.2011.

Po ashtu në bazë të provave të lëndës, Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Shtimes, nuk ka dhënë informatë nëse ndaj ankuesit është bërë shuarja e masës disiplinore për faktin

që Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 83 paragrafi 15, ka përcaktuar se: **“Masat disiplinore, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë edhe sipas këtij ligji. Zbatimi dhe fshirja e masës do të bëhet sipas këtij ligji”**, në këtë kuptim meqë masa fillestare ndaj ankuesit është shqiptuar më datë 28.08.2018 me Vendim me Nr. 01/ID.Nr.74 të Komisionit Disiplinor dhe meqenëse kanë kaluar tri (3) vite nga shqiptimi i kësaj mase, atëherë në pajtim me nenin 51 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Shtimes, është i obliguar të bëjë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi për Zyrtarët Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRTËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1058/2021

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës



Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Z. [redacted] -Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.